

URDHËR
Nr. 142, datë 21.3.2023

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; dhe të pikës 2, të nenit 11 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave z. Endrit Hoxha, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, për ndjekjen e procedurave për financimin e projekteve në fushën e sportit, propozuar nga federatat joolimpike, sipas përcaktimeve në udhëzimin e përbashkët nr. 4, datë 25.2.2022, “Për mënyrën e përdorimit të fondit ‘Grant/transferte korrente e brendshme’ për federatat sportive olimpike, Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizatën Kombëtare Antidoping”.

2. Kompetencat e deleguara ushtrohen deri në përfundimin e procedurës, sipas pikës 1 të këtij urdhri, për vitin 2023.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri z. Endrit Hoxha, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi